



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 25.3.2023

Nr: 13

Ora: 15.00

V E N D I M

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 8, DATË 23.2.2023, TË  
KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR  
PËRCAKTIMIN E RENDITJES SË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE KANDIDATËVE NË FLETËT  
E VOTIMIT NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE"**

Në mbështetje të neneve 20, pika 1, shkronja "a", e 98, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

a) Në nenin 2, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si vijon:

- "1. Renditja e subjekteve zgjedhore dhe e kandidatëve për kryetar të njësive të qeverisjes vendore në fletët e votimit bëhet nga numri më i vogël te numri më i madh, sipas përzgjedhjes rastësore (short) të numrave natyrorë.
2. Renditja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për këshillin e bashkisë bëhet në katër faza, si vijon:
  - a) Në fazën e parë përfshihen në short subjektet zgjedhore të cilat kanë regjistruar lista shumemërore kandidatësh në të gjitha zonat zgjedhore.
  - b) Në fazën e dytë përfshihen në short subjektet zgjedhore të cilat kanë regjistruar lista shumemërore kandidatësh nga 31 deri 60 zona zgjedhore.
  - c) Në fazën e tretë përfshihen në short subjektet zgjedhore të cilat kanë regjistruar lista shumemërore kandidatësh deri në 30 zona zgjedhore.
  - ç) Në fazën e katërt përfshihen në short kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë, në rast se për një zonë zgjedhore regjistrohen dy ose më shumë kandidatë. Shorti do të hidhet ndërmjet tyre.

Në renditjen përfundimtare kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për këshillin e bashkisë vendosen pas renditjes së partive politike dhe

Data: 25.3.2023

Nr: 13  
Ora: 15.00



"Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.8,  
datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator"

koalicioneve.”.

b) Në nenin 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. Në fund të fjalisë së parë të pikës 1, të nenit 4, shtohen fjalët “...për secilën fazë...”.

ii. Shkronja “a”, e pikës 1 ndryshohet si vijon:

“a) Parashorti për secilën fazë zhvillohet si më poshtë:”.

iii. Shkronja “b”, e pikës 1 ndryshohet si vijon:

“b) Shorti për fazën e parë zhvillohet si më poshtë:”.

iv. Pas shkronjës “b”, shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) E njëjta procedurë e përcaktuar në shkronjën “b” ndiqet për çdo fazë. Numrat e përfshirë në short janë në rend rritës dhe të barabartë me numrin e subjekteve që marrin pjesë në secilën fazë. Numrat që shënohen në shiritat e letrës të përfshirë në fazën/fazat pararendëse nuk përfshihen në fazën vijues.”.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO**

**Kryetar**

**Arens ÇELA**

**Anëtar**

**Dritan ÇAKA**

**Anëtar**

**Helga VUKAJ**

**Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ**

**Anëtar**

Data: 25.3.2023

Nr: 13

Ora: 15.00



“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator”

Kopje: 3  
Afati i ruajtjes: 5 vjet  
kompjuterizoi:  
E.Dushallari \_\_\_\_\_  
M.Koja \_\_\_\_\_  
D.Alimemeti \_\_\_\_\_  
A.Lamçe \_\_\_\_\_  
M.Çelmeta \_\_\_\_\_  
Y.Merkaj \_\_\_\_\_

